



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK
TIRANË


Rruga: “Aleksandër Moisiu”, Nr 80, Tiranë, Albania.
Tel: +355 4374756, Fax 355 43 70058

Tiranë, 20/11/ 2009

BULETINI EPIDEMIOLOGJIK MBI QARKULLIMIN E GRIPIT TE RI
PANDEMIK A(H1N1) NE SHQIPERI


Me poshte jepet nje pershkrim i gjendjes epidemiologjike dhe pasojave shendetesore lidhur me Gripin e ri pandemik A(H1N1) ne Shqiperi deri ne daten 20 Nentor 2009.

Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 25 - 46 të vitit 2008 dhe të vitit 2009. Numri i rasteve. (përkatesisht deri me dt. 15. 11. 2009).




- Kemi nje numer me te larte te infeksioneve respiratore krahasuar me nje vit me pare. Kete jave verejme nje trend ne rritje te numrit te infeksioneve respiratore krahasuar me javen paraardhese. Aktualisht jemi ne fazen e aktivitetit sezonal te pritshem.
- Numri me i madh i rasteve te infeksioneve respiratore verehet ne moshat feminare.

Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




- Nuk kemi shperthim epidemik te infeksioneve te ngjashme me Gripin. Numri javor i rasteve eshte i ulët krahasuar me pragun epidemik
- Lidhur me gripin e ri A/H1N1, deri ne daten 19 Nentor 2009, jane marre 1579 mostra nga Tirana dhe rrethet. Numri me i madh i mostrave eshte marre ne grupmoshen 25 - 44 vjeç ku dhe vihet re dhe numri me i madh i rasteve te konfirmuara.
- Numri i pergjithshem i rasteve te konfirmuara me virusin A(H1N1) deri ne daten 19 Nentor 2009 eshte **147**. Moshja mesatare e rasteve te prekura ne total eshte 22 vjeç ndersa e rasteve te javes se fundit eshte 16.5 vjeç. Shumica dermuese e rasteve jane konfirmuar ne Tirane.
- Perveç virusit te Gripit te Ri Pandemik A/H1N1 cdo dite konfirmohen raste me virusin e Gripit te Zakonshem Stinor cka deshmon qarkullimin e perbashket e te dy viruseve ne popullate
- Shenjat klinike te rasteve te konfirmuara gjate dy javeve te fundit kane qene te lehta dhe mesatare. Eshte regjistruar nje rast i rende (sindrom i rende respirator akut), i shtruar ne spitalin pneumoftiziatrik
- Survejanca ne te gjithe vendin eshte plotesuar me informacionin mbi shtrimet ne te gjitha spitalet e vendit dhe eshte perforcuar survejanca per zbulimin dhe monitorimin e rasteve me semundje te rende respiratore.


Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas javes se raportimit



Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas grupmoshes



Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas rretheve



Frekuenca e hasjes së Infeksioneve Respiratore (të Sipërme dhe të Poshtëme) sipas rretheve në javën e 45-të dhe javën e 46-të të vitit 2009. Incidenca (raste/10.000)

